



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.998/20
999/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “MARISA” SH.P.K & “Company Murseli” Shpk-Gjakovë, si dhe OE N.SH.T “VIKTORY COM” Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “Joos&Krasniqi Baze” dhe “Vizion Plus”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc” me nr. të prokurimit: 632-20-1308-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, më datën: 15.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik “MARISA” SH.P.K & “Company Murseli” Shpk-Gjakovë, si dhe OE N.SH.T “VIKTORY COM” Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc” me nr. të prokurimit: 632-20-1308-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS.

II. VËRTETOHET, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc” me nr. të prokurimit: 632-20-1308-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik “MARISA” SH.P.K & “Company Murseli” Shpk-Gjakovë, si dhe OE: N.SH.T “VIKTORY COM” Gjakovë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i’u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “MARISA” SH.P.K & “Company Murseli” Shpk-Gjakovë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 23.11.2020 me nr. 998/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc” me nr. të prokurimit: 632-20-1308-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 56, 59, 60, 69 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues N.SH.T “VIKTORY COM” Gjakovë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 23.11.2020 me nr. 999/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc” me nr. të prokurimit: 632-20-1308-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 56, 59, 60, 69 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 30.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket vlerësimeve të pretendimeve të OE MARISA SH.P.K& Company Murseli

Shpk fillimishtë sqaron se, ky aktivitet i prokurimit ka filluar me datën 10.04.2020 Njoftimi për kontratë, ku hapja e ofertave është bërë më datën 05.05.2020, dhe AK pas vlerësimit të ofertave me datë 28.05.2020 ka njoftuar ofertuesit për rekomandim për dhënien e kontratës OE JOOS & KRASNIQT-BAZE SH.P.K.; N.P.N." VIZION-PLUS, të njejtën kohë në AK është ankuar me kërkesën për shqyrtim OE "Marisa SHPK" i cili ka qenë kundër njoftimit për dhënie të kontratës dhe AK ka aprovuar ankesën e të njejtit, lënda është kthyer në rivlerësim. Me datë 23.06.2020 nga AK është bërë rivlerësimi dhe i njejtë vendosë që për kontratë të rekomandoj OE ankuesin "Mariza "SHPK, pas njoftimit të AK-së kemi pranuar ankesë nga OE tani i rekomanduari OE JOOS & KRASNIQT-BAZE SH.P.K.; N.P.N." VIZION-PLUS, ku i njejtë pretendon se OE i rekomanduar nuk i plotëson kriteret, dhe më datë 07.08.2020 OSHP nxjerr vendimin PSH.463/20 ku aprovohet ankesa e OE ankues pjesërishtë dhe lënda kthehet në rivlerësim. Me datë 28.08.2020 bëhet rivlerësimi dhe rekomandohet prap OE Mariza SHPK, pas njoftimit nga AK, OE Joos&Krasniqi-Baze SHPK ankohet në OSHP kundër OE Mariza SHPK dhe me datë 22.10.2020 OSHP nxjerr vendimin PSH.656/20 ku aprovohet ankesa e OE ankuesit dhe lënda kthehet prap në rivlerësim, gjerësa tani me datë 06.11.2020 AK ka bërë rivlerësimin e III-të dhe ka vendosur që për kontratë të rekomandoj OE JOOS & KRASNIQT-BAZE SH.P.K.; N.P.N." VIZION-PLUS, tani ankues e kemi "Marisa SHPK&Company Murseli SHPK ku i njejtë pretendon se AK ka bërë shkeljen e LPP_së me rekomandimin e OE OE JOOS & KRASNIQT-BAZE SH.P.K.; N.P.N." VIZION-PLUS.

Pretendimi i parë OE ankues kundër OE i rekomanduari:

OE i cilësuar nga AK Komuna e Gjakovës si i suksesshëm nuk i plotëson as kriteret minimale për kontratë siç janë:

1. Grupi i OE Joos & Krasniqi Baze dhe Vizion Plus nuk e kane plotësuar si duhet Deklaratat nen Betim ku ju mungon Numri i Prokurimit dhe automatikisht do duhet te refuzohet dhe te diskualifikohet.

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimeve të OE ankuesit "Marisa" SHPK & "Company Murseli" sqaron se, AK në dosje të tenderit ka bashkangjitur deklaratat vetëm me titull të aktivitetit të prokurimit ndërsa numrin e prokurimit nuk e ka shkruar edhe pse mund të themi se është më tepër gabimi i vogël teknik nga ana e AK-së, andaj OE i rekomanduar ka shkarkuar të njejtat deklarata nga dosja e tenderit, por vlenë të theksohet se OE i rekomanduar Deklaratat për specifikime teknike i ka të plotësuar me nr të prokurimit dhe me titull të aktivitetit të prokurimit.

Bashkangjitur gjeni deklaratën e DT-së nga AK, si dhe deklaratën e lartcekur për specifikime teknike.

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj nën betim se jam i përshatshëm në përputhje me Nenin 63, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 03/L-068 dhe ligjin Nr. 03/L-92.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedure të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtëse të gabueshme ose rrethimtare.



Zyrës së Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Deklarata për Specifikacione Teknike

"Joos & Krasniqi-Bazë" Sh.p.k deklaron se do i përmbushet Specifikacione Teknike të Detyrueshme për punët e ofrimit e cila përputhet me ato të përshkruara në ANEKSIN 1, të dosjes së tenderit nga Komuna e Gjakovës për tenderin me titull:

Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc

me nr të Prokurimit: 632-20-1308-S-2-1 e m të Brevësimit: 632-20-013-521.



Ekspertja tutje sqaron, se AK në kërkesën për rishqyrtim nga OE ankuesi Viktory COM NSHT, sa i përket pretendimit të njëjtë lidhur me deklaratën nën betim, i ka dhënë po të njëjtën përgjigje ankuesit:

Pretendimi juaj I-rë se:

Grupit të operatorëve ekonomik "Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k. & N.P.N."Vizion Plus", ju mungon nr.i prokurimit në Deklaratën nën Betim, nuk qëndron, sepse Deklarata nën betim e Grupit të operatorëve ekonomik "Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k. & N.P.N."Vizion Plus", është identike me deklaratën në dosjen e tenderit;

Andaj pretendimi i parë gjendet pjesërisht i bazuar.

Sa i përket pretendimit të dytë të OE ankuesit kundër OE i rekomanduari:

2.Grupi i OE Joos&Krasniqi Baze dhe Vizion Plus nuk kanë asnjë reference të natyrës se ngjashme ku ceket ndërtim i shtegut por vetëm asfaltim të rrugëve dhe Projekti në fjalë nuk ka të bëjë asgjë me asfaltim, gjithashtu në projekt janë paraparë të ketë edhe ulës shporta shkallë kurse këto asnjë nuk e bëjnë të ngjashme

me projektin ne fjale.

Ekspertja shqyrtuese pretendimin e dytë e gjënë të **pa bazuar**, me faktin se referencat e OE të rekomanduarit janë të ngjashëm, meqë pjesa më e madhe në paramasë ka të bëjë me punët gërmimet, punët e objekteve, punët e zhavorit etj. Po ashtu edhe AK ka sqaruar se edhe asfaltimi i rrugëve konsiderohet ndërtim i ulët dhe se merret si e mirëqenë.

Përgjigja e AK-së në kërkesën për rishqyrtim të OE ankuesit Viktoy NSHT

Pretendimi juaj i II-të se:

Grupit të operatorëve ekonomik "Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k. & N.P.N."Vizion Plus", nuk ka referenca të natyrës së ngjajshme ku ceket ndërtimi i shtegut por vetëm asfaltimi i rrugëve, nuk qëndron sepse si ndërtimi i shtigjeve ashtu edhe asfaltimi i rrugëve hyjin te ndërtimet e ulëta, prandaj mirret se janë të natyrës së ngjajshme;

Ekspertja Shqyrtuese tutje sqaron se, OE ankuesi Marisa SHPK pretendon se:

Oferta e Grupit tone ka qene ofertat me çmimin me te ulet ne këtë aktivitet te prokurimit ku i kemi plotësuar te gjitha kriteret për kontratë, pra sipas LPP dhe nenit 1 Qëllimi ne duhet te jemi fitues i këtij aktiviteti te prokurimit.

Ne kemi dërguar një Sigurim e tenderit edhe kemi fakte qe sigurimi I tenderi është bere para kohës se hapjes sepse kemi edhe dëshmi sepse kemi komunikuar me kompaninë e sigurimeve për mes emailit dhe kemi fakte.

Ne jemi konsultuar edhe me Monitoruesit e E-Prokurimit dhe kane konstatuar se ne i plotësojmë kushtet edhe se aji gabim mund te arsyetohet nëse sigurimi është bërë para orës se hapjes se Ofertave, dhe ne këtë e dëshmojmë me emaila te cilat kemi komunikuar me Sigurimin e tenderëve dhe ku shihet ora date se kur ka ardhur sigurimi tek ne.

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të OE ankuesit sqaron se, lidhur me këtë pretendim OSHP ka nxjerr dy here vendim dhe ka konsideruar se sigurimi i tillë nuk merret si i mirëqenë, andaj edhe jeni refuzuar, pra pretendimi gjendet i **pa bazuar**!

Vendimi PSH 656/20 dt:22.10.2020

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se lidhur me këtë pretendim OSHP ka sqaruar dhe ka nxjerr vendimi nr 463/20 të datës 07.08.2020 ku është konstatuar: "Andaj paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi i ankuesit për sigurimin e tenderit për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës është i pa bazuar, për faktin se Sigurimi i tenderit në ofertë është i ngarkuar komplet gabimisht, që sigurimi i tenderit ndërlihet krejtësisht me një aktivitet tjetër të prokurimit, numër tjetër të prokurimit, ku gjithashtu edhe nuk është plotësuar plotësisht (mungon nënshkrimi i të siguruarit, shuma është gabim) "Andaj Paneli Shqyrtues në pajtim me nenin 39 të RRUPP konstaton se nëse sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara, tenderi duhet të refuzohet, ashtu siç edhe përcaktohet tek neni 39 pjesa 57 të RRUOPP në të cilin thuhet: Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë e DT; Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm 57;

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankuesit është i bazuar, për faktin se Sigurimi i Tenderit nuk tolerohet të ngatërrohet dhe se sipas LPP-së nëse Ofertuesi nuk i plotëson kriteret e FDT-së shpallet i pa përgjegjshëm.

Gjersa sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit të dytë Viktory COM NSHT:

Pretendimi i parë OE ankuesit kundër OE i rekomanduari:

OE i cilësuar nga AK Komuna e Gjakovës si i suksesshëm nuk i plotëson as kriteret minimale për kontratë siç janë:

1. Grupi i OE Joos & Krasniqi Baze dhe Vizion Plus nuk e kanë plotësuar si duhet Deklaratat nën Betim ku ju mungon Numri i Prokurimit dhe automatikisht do duhet të refuzohet dhe të diskualifikohet.

Ekspertja Shqyrtuese konsideron se pretendimi i OE ankuesit gjendet **pjesërisht i bazuar** për faktin se siç e potencuam edhe më lartë tek OE ankuesi i parë Marisa SHPK, deklarata nën betim ka qenë e shkarkuar nga dosja e tenderit, gjersa AK nuk ka bashkangjitur numrin e prokurimit në këtë rast, andaj nuk mund ta konsiderojmë si gabim i OE të rekomanduarit. (Shih më lartë përgjigjen me fakte tek OE ankuesi Marisa SHPK)

Pretendimi i dytë OE ankuesit kundër OE i rekomanduari:

2. Grupi i OE Joos & Krasniqi Baze dhe Vizion Plus nuk kanë asnjë referencë të natyrës së ngjashme ku ceket ndërtim i shtegut por vetëm asfaltim të rrugëve dhe Projekti në fjalë nuk ka të bëjë asgjë me asfaltim, gjithashtu në projekt janë paraparë të këtë edhe ulës shporta shkallë kurse këto asnjë nuk e bëjnë të ngjajshëm me projektin në fjalë.

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të dytë të OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit lidhur me kontratat e ngjajshme sipas FDT-së, mendoj se kontratat përkojnë me paramasën e AK-së, për arsye se gërmimi, punët e zhavorit etj, konsiderohen ndërtim i ulët. Siq sqaruam edhe tek OE ankuesi i parë lidhur me këtë pretendim!

Si konkludim, Ekspertja Shqyrtuese mendon se pretendimet e OE ankuesve Marisa SHPK dhe Viktory COMNSHT qëndrojnë pjesërisht të bazuara, dhe si përfundim rekomandohet që ankesat të aprovohen pjesërisht, gjerës vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesat e OE ankuesve **pjesërisht të aprovohen**, dhe vendimi i AK-së të mbetet në fuqi!

Autoriteti Kontraktues, me datë: 30.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "MARISA SH.P.K& Company Murseli Shpk, Nuk ka pergjigje

Operatori Ekonomik N.SH.T "VIKTORY COM", nuk ka pergjigje

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtratat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i cilësuar nga AK Komuna e Gjakovës si i suksesshëm nuk i plotëson as kriteret minimale për kontratë siç janë:

1. Grupi i OE Joos & Krasniqi Baze dhe Vizion Plus nuk e kane plotësuar si duhet Deklaratat nen Betim ku ju mungon Numri i Prokurimit dhe automatikisht do duhet te refuzohet dhe te diskualifikohet.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK në dosje të tenderit ka bashkangjitur deklaratat vetëm me titull të aktivitetit të prokurimit ndërsa numrin e prokurimit nuk e ka shkruar edhe pse mund të konstatohet se një gabim i vogël teknik nga ana e AK-së. Andaj, OE i rekomanduar ka shkarkuar të njëjtat deklarata nga dosja e tenderit por vlen të theksohet se OE i rekomanduar deklaratat për specifikime teknike i ka të plotësuara me nr. të prokurimit dhe me titull të aktivitetit të prokurimit. Për më tepër, Paneli Shqyrtues sqaron se eksperti ka bashkangjitur në raport deklaratën e dosjes së tenderit nga AK, si dhe deklaratën e lartcekur për specifikime teknike.

Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK në kërkesën për rishqyrtim nga OE ankuesi Viktory COM NSHT, sa i përket pretendimit të njëjtë lidhur me deklaratën nën betim, i ka dhënë po të njëjtën përgjigje ankuesit:

Pretendimi juaj 1-rë se:

Grupit të operatorëve ekonomik "Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k. & N.P.N. "Vizion Plus", ju mungon nr. i prokurimit në Deklaratën nën Betim, nuk qëndron, sepse Deklarata nën betim e Grupit të operatorëve ekonomik "Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k. & N.P.N. "Vizion Plus", është identike me deklaratën në dosjen e tenderit;

Andaj pretendimi i parë gjendet pjesërisht i bazuar.

Sa i përket pretendimit të dytë të OE ankues kundër OE të rekomanduar, se:

2. Grupi i OE Joos&Krasniqi Baze dhe Vizion Plus nuk kanë asnjë reference të natyrës se ngjashme ku ceket ndërtim i shtegut por vetëm asfaltim te rrugëve dhe Projekti ne fjale nuk ka te bej asgjë me asfaltim,

gjithashtu ne projekt janë paraparë te ketë edhe ulës shporta shkallë kurse këto asnjë nuk e bëjnë te ngjashme me projektin ne fjale.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimi i dytë është i pa bazuar për faktin se referencat e OE të rekomanduar janë të ngjashme, meqë pjesa më e madhe në paramasë ka të bëjë me punët gërmimet, punët e objekteve, punët e zhavorrit, etj. Po ashtu, edhe AK ka sqaruar se edhe asfaltimi i rrugëve konsiderohet ndërtim i ulët dhe se merret si e mirëqenë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues tutje sqaron se OE ankues Marisa SHPK pretendon se: Oferta e Grupit tone ka qene ofertat me çmimin me te ulet ne këtë aktivitet te prokurimit ku i kemi plotësuar te gjitha kriteret për kontratë, pra sipas LPP dhe nenit 1 Qëllimi ne duhet te jemi fitues i këtij aktiviteti te prokurimit. Ne kemi dërguar një Sigurim e tenderit edhe kemi fakte qe sigurimi I tenderi është bere para kohës se hapjes sepse kemi edhe dëshmi sepse kemi komunikuar me kompaninë e sigurimeve për mes emailit dhe kemi fakte. Ne jemi konsultuar edhe me Monitoruesit e E-Prokurimit dhe kane konstatuar se ne i plotësojmë kushtet edhe se aji gabim mund te arsyetohet nëse sigurimi është bërë para orës se hapjes se Ofertave, dhe ne këtë e dëshmojmë me emaila te cilat kemi komunikuar me Sigurimin e tenderëve dhe ku shihet ora date se kur ka ardhur sigurimi tek ne.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me këtë pretendim, OSHP ka nxjerr dy herë vendim dhe ka konsideruar se sigurimi i tillë nuk merret si i mirëqenë, andaj edhe jeni refuzuar, pra pretendimi gjendet i pa bazuar.

Kurse, sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit të dytë Viktory COM NSHT, se OE i cilësuar nga AK Komuna e Gjakovës si i suksesshëm nuk i plotëson as kriteret minimale për kontratë siç janë:

1. Grupi i OE Joos & Krasniqi Baze dhe Vizion Plus nuk e kanë plotësuar si duhet Deklaratat nen Betim ku ju mungon Numri i Prokurimit dhe automatikisht do duhet te refuzohet dhe te diskualifikohet.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konsideron se pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar për faktin se siç e potencuam edhe më lartë tek OE ankuesi i parë Marisa SHPK, deklarata nën betim ka qenë e shkarkuar nga dosja e tenderit, gjersa AK nuk ka bashkangjitur numrin e prokurimit në këtë rast, andaj nuk mund ta konsiderojmë si gabim i OE të rekomanduarit. Për më tepër, referojuni përgjigjes më lartë.

Pretendimi i dytë i OE ankues kundër OE i rekomanduari:

2. Grupi i OE Joos&Krasniqi Baze dhe Vizion Plus nuk kanë asnjë referencë të natyrës se ngjashme ku ceket ndërtim i shtegut por vetëm asfaltim te rrugëve dhe Projekti ne fjale nuk ka te bëjë asgjë me asfaltim,

gjithashtu ne projekt janë paraparë te këtë edhe ulës shporta shkallë kurse këto asnjë nuk e bejn te ngjajshem me projektin ne fjale.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se sa i përket pretendimit të dytë të OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit lidhur me kontratat e ngjashme sipas FDT-së, kontratat përkojnë me paramasën e AK-së për arsye se gërmimi, punët e zhavorrit, etj. konsiderohen ndërtim i ulët siç është sqaruar edhe tek OE ankues i parë lidhur me këtë pretendim.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, duke rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik që ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka ofertuar me çmim me te lire nga te gjithë ofertuesit e përgjegjshëm. Dhe se autoriteti kontraktues me rastin e rivlerësimit të ofertave i është përmbajtur në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK KOMUNA E GJAKOVËS;
- 1x1 OE MARISA SH.P.K& Company Murseli Shpk;
- 1x1 OE N.SH.T "VIKTORY COM";
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.